

UDHËZIM
Nr. 15, datë 10.4.2025

MBI TREGUESIT OSE SHENJAT QË IDENTIFIKOJNË LOT-in
TË CILIT I PËRKET NJË PRODUKT USHQIMOR¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 4, kreu II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 11.7.2018, “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”,

UDHËZOJ:

Neni 1

1. Ky udhëzim ka për qëllim të forcojë sistemin e gjurmueshmërisë së produkteve ushqimore nëpërmjet vendosjes në faza të ndryshme të zinxhirit ushqimor të *lot*-it, të formuluar me tregues identifikues me shkronja ose numra, duke u mundësuar autoriteteve kompetente dhe operatorëve të biznesit të monitorojnë dhe të menaxhojnë në mënyrë efektive produktet ushqimore.

2. Për qëllimet e këtij udhëzimi, “*lot*” nënkupton një sasi të identifikueshme të një produkti ushqimor të dorëzuar në të njëjtën kohë dhe që është prodhuar, përpunuar ose paketuar praktikisht në të njëjtat kushte.

Neni 2

1. Produktet ushqimore tregtohen vetëm nëse përmbajnë *lot*-in me treguesit identifikues të përmendur në nenin 1, të pikës 1, të këtij udhëzimi.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet:

- a) për produktet bujqësore, të cilat, pas largimit nga ferma, janë:
 - i. shitur ose dorëzuar në stacionet e magazinimit, përgatitjes ose paketimit të përkohshëm;
 - ii. transportohen tek organizatat e prodhuesve; ose
 - iii. mbledhen për përfshirje të menjëhershme në një proces përgatitjeje ose përpunimi;
- b) në pikën e shitjes të konsumatori i fundit, kur produktet ushqimore nuk janë të parapaktuara, janë të paketuara me kërkesë të blerësit ose janë të parapaktuara për shitje të menjëhershme;
- c) për paketimet ose kontejnerët, ana më e madhe e të cilave ka një sipërfaqe më të vogël se 10 cm²;
- ç) në porcione individuale të akullores, treguesi që mundëson identifikimin e *lot*-it të tregohen në paketimin e kombinuar.

Neni 3

1. *Lot*-i përcaktohet në çdo rast nga prodhuesi ose ambalazhuesi i produktit ushqimor, ose shitësi i parë në Republikën e Shqipërisë.

2. Treguesit e përmendur në nenin 1, të pikës 1, të këtij udhëzimi, përcaktohen dhe vendosen nën përgjegjësinë e operatorëve që kryejnë procese specifike në zinxhirin ushqimor. Treguesit të paraprihen nga shkronja “L”, me përjashtim të rasteve kur dallohet qartë nga treguesit e tjerë në etiketë ose ambalazh.

Neni 4

1. Në rastin e produkteve ushqimore të parapaktuara, treguesi i përmendur në nenin 1, të pikës 1, të këtij udhëzimi, dhe sipas rastit, shkronja “L”, do të shfaqet në paketim ose në një etiketë bashkëngjitur.

¹ Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me direktivën 2011/91/BE, e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e 13 dhjetorit 2011 “Mbi treguesit ose shenjat që identifikojnë lotin të cilit i përket një produkt ushqimor”.

2. Kur produktet ushqimore nuk janë të paketuara paraprakisht, treguesi i përmendur në nenin 1, të pikës 1, të këtij udhëzimi, dhe sipas rastit, shkronja “L” vendoset në paketim ose në kontejner ose, në rast të kundërt, në dokumentet shoqëruese tregtare.

3. Treguesit të vendosen në të gjitha rastet në mënyrë të tillë që të jenë lehtësisht të dukshëm, qartësisht të lexueshëm dhe të pashlyeshëm.

Neni 5

1. Kur në etiketë është vendosur data e jetëgjatësisë minimale ose “të përdoret deri ...”, treguesit e përmendur në nenin 1, të pikës 1, të këtij udhëzimi, nuk vendosen në etiketën e produktit ushqimor, me kusht që data konsiston të paktën në tregues të pakoduar të datës dhe muajit duke ruajtur radhën e vendosjes.

Neni 6

1. Produktet ushqimore të etiketuara përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi do të vazhdojnë të tregtohen deri në mbarimin e stokeve. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të evidentojë sasinë stok të këtyre produkteve deri në shitjen e plotë të tyre.

Neni 7

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Udhëzimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj